



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI I LËNDËS

SINTAKSË E GJUHËS B

Titullari /pedagogu i lëndës: Dr. Elda KATORRI

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 20 leksione/20 seminare

Tipologjia e lëndës: B

Viti akademik: Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: Viti II / Semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: “Bachelor” - *Gjuhë, letërsi dhe qytetërim italian*

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës: elda.katorri@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Ky kurs synon të paraqesë një hyrje në teoritë themelore të sintaksës, lidhjet e saj me disiplinat e tjera gjuhësore, konceptet themelore të strukturës gramatikore, lidhjet gramatikore mes fjalëve dhe funksionet e tyre brenda fjalisë, bashkimit të fjalëve në togfjalësha, të togfjalëshave në fjali e të fjalive në periudhë sipas marrëdhënieve të tyre kuptimore apo formave gramatikore që shfaqen gjatë ligjërimit. Përdorimi dhe zbatimi në praktikë i disa prej modeleve të analizës sintaksore do t'i volisë së tepërmi procesit të mësimdhënies dhe atij të përkthimit, në kontekste shkollore apo profesionale.

Rezultatet e të nxënit: Në fund të këtij kursi studenti do të jetë i aftë të asimilojë konceptet kryesore të shkollave të ndryshme gjuhësore mbi sintaksën dhe evolucionin e kësaj discipline; të punojë me fjalën, togfjalëshin, fjalinë dhe periudhën duke analizuar marrëdhëniet që ekzistojnë mes tyre; të dallojë gjymtyrët kryesore të fjalisë: kryefjalë dhe kallëzues; gjymtyrët e dyta të saj: kundrinor, rrethanor, përcaktor etj. dhe pjesët e ligjëratës me të cilat shprehen ato; të dallojë tipat e fjalive sipas llojit të kumtit që ato shprehin, si fjalia dëftore, pyetëse, nxitëse, dëshirore, habitore etj.; të dallojë marrëdhëniet e bashkërenditjes dhe të nënrenditjes në kontekstin e fjalisë së përbërë dhe lidhëzat përkatëse të cilat shprehin këtë lloj marrëdhënieje; të dallojë ligjëratën e drejtë dhe ligjëratën e zhdrejtë si edhe të përvetësojë rregullat gramatikore të kalimit nga njëra tek tjetra.